



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kandidati: Kosova Türkçe Medya Derneği – Shoqata e Mediave Turke të Kosovës

Nr. i Regjistrimit: 5119549-3

Pronar: Kosova Türkçe Medya Derneği – Shoqata e Mediave Turke të Kosovës

Drejtor: Furkan Fuşa

Emri i propozuar: Radyo Hisar

Adresa: Rr. Vëllezrit Frashëri, Nr.29, Prizren



VENDIM

për licencimin e kandidatit Radyo Hisar, për transmetim të radio programeve, me mbulim që i përket kategorisë regjionale, në Komunën e Prizrenit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1. të, KPM licencon transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuara të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6. i ligjit për KPM, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. KPM, me datën 17 korrik 2023, ka marr vendim për shpalljen e konkursin publik për dhënien e një licence për shërbim medial audio (radio) në gjuhën turke, me mbulim regjional, për Komunën e Prizrenit. Konkursi është publikuar më datën 1 gusht 2023 dhe ka qenë i hapur për dorëzimin e aplikacioneve deri më datën 1 shtator 2023, ora 16:00.
5. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë 1. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2020/01); 2. Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02) dhe 3. Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06).
6. Me datën 31 gusht 2023 kandidati Radyo Hisar, ka dorëzuar aplikacionin për licencë të radios në gjuhën turke për Komunën e Prizrenit.

Arsyetim

7. Vendimi i KPM-së për dhënien e licencave të reja është bërë mbi bazën e nevojave të publikut dhe kapaciteteve të lira frekuencore në Komunën e Prizrenit, ku është vlerësuar se ka mungesë të

shërbimeve mediale radio me mbulim lokal në gjuhën turke si dhe mundësin e zhvillimit të pluralizmit medial.

8. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit për KPM, thekson se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”.
9. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të pranuar përmes konkursit publik, bazuar në nenin 4, paragrafi 7, të Rregullores KPM-2014/02, me datën 13 shtator 2023, ka marr vendim për formimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve.
10. Në takimin e mbajtur më 26 shtator 2023, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve ka konstatuar se, aplikacioni i Radyo Hisar është dorëzuar i kompletuar në KPM dhe në pajtim me Rregulloren KPM-2021/01, duke i plotësuar në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
11. Komisioni për Vlerësim të aplikacioneve, mbi bazën e kritereve të përcaktuara sipas nenit 22, paragrafi 4 të ligjit të KPM-së, Rregullores KPM-2021/01 si dhe në bazë të Rregullores KPM-2014/02, ka vlerësuar kandidatin Radyo Hisar me 36 pikë për *Kapacitetin për Zhvillimin e Programit Vetanak dhe Nevojën për të Siguruar Program të Shumëllojshëm për të gjithë Qytetarët në atë Zonë të Mbulimit*; me 26 pikë për *Kushtet Teknike* dhe me 25 pikë për *Qëndrueshmërinë Financiare*.
12. Komisioni konstaton se kandidati Radyo Hisar ka grumbulluar gjithsej 87 pikë gjatë vlerësimit të kritereve profesionale të përcaktuara me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
13. Komisioni vlerëson se, kandidati Radyo Hisar ka përmbushur kriteret kualifikuese për t’u pajisur me licencë të KPM-së, në pajtim me Ligjin e KPM-së, me Rregulloren KPM-2021/01, duke grumbulluar gjithsej 87, pikë për sa i përket plotësimit të kritereve profesionale për licencë të KPM-së, të vlerësuara dhe në pajtim me Rregulloren e KPM-2014/02.

Vendim

14. Komisioni merr vendim që kandidatin **Radyo Hisar** ti aprovojë kërkesën për licencë të KPM-së, mbi bazën e plotësimit të kritereve për licencë dhe bazën e pikëve të mjaftueshme të grumbulluara gjatë vlerësimit të aplikacionit (87 pikë), për t’u pajisur me licencë të KPM-së për të vepruar si shërbim mediale audio në gjuhën turke, duke ofruar programe radiofonike me interes publik për qytetarët e komunitetit turk në Komunën e Prizrenit.
15. Komisionit merr vendim që Radyo Hisar, t’i lëshojë licencën e KPM-së me mbulim që i përket kategorisë regionale.
16. Përcaktimi i parametrevave teknik si dhe caktimi i frekuencës që do të shfrytëzohet nga Radyo Hisar do të përcaktohen në Tabelën Teknike të Pakos së Licencës së KPM-së.
17. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13. 10. 2023

Data